



# DREJTËSIA CIVILE 2022

Autor: Aurela Mërlaku dhe Nuraje Bllaca

Redaktor: Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

*Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë për Çështje të Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.*

## RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

## IKD

Rr. Ilaz Agushi  
Prishtinë  
E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)  
[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

Përkrahur nga:

Gusht, 2023  
Prishtinë, Republika e Kosovës



## **Përmbajtja**

1.	Përmbledhja ekzekutive .....	4
2.	Monitorimi i drejtësisë civile .....	5
3.	Rritja e numrit të lëndëve të pazgjidhura .....	5
4.	Sfidimi i drejtësisë civile nga kontratat kolektive.....	7
5.	Ngarkesa me lëndë civile sipas llojit të kontesteve .....	9
6.	Kohëzgjatja e trajtimit të rasteve civile .....	11
7.	Mungesa e rasteve gjyqësore për diskriminim.....	11
8.	Kontestet e punës me elemente diskriminimi .....	12
9.	Mungesa e padive lidhur me sinjalizim .....	14
10.	Mbrojtja gjyqësore e pronës.....	14
11.	Ndërmjetësimi në kontestet juridiko-civile.....	17
12.	Ngarkesa në mënyrë jo proporcionale e gjyqtarëve me lëndë civile .....	18

## 1. Përmbledhja ekzekutive

Në mënyrë kronologjike, ndër vite numri i lëndëve të pazgjidhura është rritur në vazhdimësi, duke rënduar gjendjen e divizioneve civile. Përderisa në vitin 2021 kanë qenë gjithsej 85,087 lëndë të pazgjidhura të cilat janë bartur në vitin pasues, viti 2022 ka shënuar rekord të ngritjes së numrit të lëndëve të pazgjidhura me 99 mijë e 407 lëndë.

Ngritjes së numrit të lëndëve të pazgjidhura përveç ngritjes së numrit të lëndëve të pranuar, i ka kontribuar edhe mos efikasiteti i gjykatësve e edhe shpërndarja jo-proporcionale e gjykatësve. Kjo pasi numri i gjykatësve për të trajtuar lëndë kontestimore gjatë vitit 2022 ka qenë 107, derisa numri i lëndëve të zgjidhura ka qenë 25,632. Kjo i bie se secili gjykatës në mesatare brenda një viti ka zgjidhur 239.5 lëndë përkundër detyrimit nga KGJK që çdonjëri prej tyre është i obliguar t'i zgjidh 329 lëndë brenda vitit.

Mos zbatimi i Kontratave Kolektive është arsyeja kryesore e ngritjes së numrit të lëndëve civile të pranuar nga gjyqësori. Në vitin 2022 janë pranuar 40,826 lëndë të natyrës civile e që mendohet se rreth 40% e lëndëve të pranuar, janë lëndë të kësaj natyre. Kjo i bie se vetëm gjatë vitit 2022, konsiderohet se rreth 16,330 lëndë civile janë lëndë të cilat rrjedhin nga kontestet që ndërliken me moszbatimin e obligimeve nga kontratat kolektive.

Mesatarja e përgjithshme e kohëzgjatjes së lëndëve gjyqësore qartazi flet për një trajtim të lëndëve gjyqësore civile brenda një afati jo të arsyeshëm kohor. Mesatarja e kohëzgjatjes së lëndëve të zgjidhura vetëm në shkallë të parë është 1,415 ditë apo 3.8 vite kurse, mesatarja e kohëzgjatjes së trajtimit të lëndëve nga Gjykata e Apelit është 638 ditë apo 1.7 vite.

Gjatë monitorimit, IKD ka gjetur se në përgjithësi, ka mungesë të zbatimit të Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, pasi që përkundër faktit se në padi të ndryshme ngritët pretendimi për diskriminim, paditë nuk ngritën në bazë të këtij ligji, me kërkesën për të konstatuar ekzistimin e ndonjë prej formave të diskriminimit.

Po ashtu, mungesa e padive, krahas indikatorëve të tjerë, flet për nivel jo të mjaftueshëm të zbatimit të Ligjit Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Për këtë arsye promovimi i mëturjemë i këtij ligji mbetet një domosdoshmëri e institucioneve.

Lidhur me trajtimin e rasteve pronësore, bazuar në analizën e 20 aktgjykimeve, del se mesatarja e kohëzgjatjes së trajtimit të lëndëve lidhur me çështjet pronësore në shkallë të parë është 9 vite e 3 muaj, kurse mesatarja e trajtimit të lëndëve që rrjedhin nga kontratat kolektive del të jetë 1 vit e 7 muaj, e që ky dallim kaq i lartë tregon se në vitin 2022 ka pasur anashkalim të kontesteve pronësore dhe fokusim në raste të kontratave kolektive.

Sa i përket ndërmjetësimit si mënyrë alternative e zgjidhjes së kontesteve, IKD gjen se viti 2022 ka një trend të theksuar pozitiv, kjo pasi që gjatë këtij viti gjykatat në këtë procedurë kanë referuar gjithsej 4,269 raste.

## 2. Monitorimi i drejtësisë civile

Ky raport është rezultat i monitorimit të drejtpërdrejtë që Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) i ka bërë drejtësisë civile në Kosovë. Gjatë vitit 2022, IKD ka monitoruar gjithsej 492 seanca gjyqësore të natyrës civile. Prej tyre, 401 seanca janë mbajtur, derisa 91 të tjera janë shtyrë. Shprehur në përqindje, i bie se 81.5% e seancave gjyqësore civile janë mbajtur kurse 18.5% e tyre janë shtyrë.<sup>1</sup>



Arsyeja më e madhe e shtyrjes së seancave gjyqësore del të jetë mungesa e paditësit (37 raste), pasuar nga mungesa e të paditurit (35 raste). Por, në jo pak raste, edhe vet gjykatësit kanë qenë arsyeja pse seancat gjyqësore në rastet civile janë shtyrë.



Nëse e analizojmë si trend, numri i seancave gjyqësore të shtyra ka pësuar rënie vit pas viti. Ky konsiderohet një trend pozitiv. Për më tepër, ky trend në një përqindje të lehtë shprehet edhe në këtë raport. Kjo pasi në raportin e kaluar mbi drejtësinë civile, IKD kishte gjetur se përqindja e seancave të shtyra kishte qenë 21.8%, derisa këtë vit kjo përqindje ka rënë për 3.3%, përkatësisht në 18.5%. Përkundër këtij përmirësimi, kjo statistikë tregon se ende afërsisht çdo e pesta seancë gjyqësore në rastet civile shtyhet. Kjo situatë nënkupton se në fushën e administrimit adekuat të drejtësisë, që nuk lejon shtyrjen e seancave, kërkohet ende përmirësim.

## 3. Rritja e numrit të lëndëve të pazgjidhura

Numri i madh i lëndëve të pazgjidhura vazhdon të eklipsojë problemet e tjera në fushën e drejtësisë civile. Një numër i madh i problemeve në këtë fushë konsiderohen se vijnë pikërisht nga numri i madh i lëndëve të pazgjidhura. Strategjia për Sundim të Ligjit thekson se: “Nga

<sup>1</sup> Shih linkun: <https://www.ejudiciary.org/kli>. (Qasur për herë të fundit më 20 janar 2023).

*lëndët e grumbulluara, problematike në veçanti është kohëzgjatja e lëndëve civile*<sup>2</sup>. Kjo ngarkesë, përpos kohëzgjatjes, mund të konsiderohet se ndikon edhe në cilësinë e vendimeve të gjykatave.

Në raportin mbi drejtësinë civile për vitin 2018, IKD gjente se ka një ulje shumë të vogël të numrit të lëndëve të pazgjdhura. Me këtë tempo, IKD theksonte se drejtësisë civile në Kosovë do t'i duhej kohë e gjatë për tu stabilizuar<sup>3</sup>. Fatkeqësisht, që nga ajo kohë, ka ndodhur tërësisht e kundërta: numri i lëndëve të pazgjdhura në fushën civile tanimë është dyfishuar.

Në mënyrë kronologjike, që nga viti 2018 e deri në fund të vitit 2022, numri i lëndëve të pazgjdhura është rritur në vazhdimësi, duke rënduar gjendjen e divizioneve civile sa i përket ngarkesës me lëndë.



**Tabela 3. Lëndët e pazgjdhura nga Gjykatat Themelore në vitet 2018-2022.**

Përderisa në vitin 2021 kanë qenë gjithsej 85,087 lëndë të pazgjdhura<sup>4</sup> të cilat janë bartur në vitin pasues, viti 2022 ka shënuar rekord të ngritjes së numrit të lëndëve të pazgjdhura të cilat barten vit pas viti, me 99,407 lëndë të pazgjdhura.<sup>5</sup>

<sup>2</sup> Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021 – 2026. Ministria e Drejtësisë. Korrik 2021. Faqe 12. (Shih linkun: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6DC1CBD5-0DF1-46AE-9D1A-78C96146C7D0.pdf>). (Qasur për herë të fundit 29 qershor 2023).

<sup>3</sup> Nocaj D. “Drejtësia civile në Kosovë, ligji VS praktika”. IKD. Prishtinë. Nëntor 2019. Faqe 15 (Shih linkun <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/11/IKD-Drejt%C3%ABsia-Civile-Ligji-vs.-Praktika-03.11.2019-1.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 29 qershor 2023).

<sup>4</sup> Raport statistikor i Gjykatave Vjetor 2021. (Shih linkun: [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/91632\\_KGJK\\_Raporti\\_Statistikor\\_Vjetor\\_Gjykatave\\_2021.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/91632_KGJK_Raporti_Statistikor_Vjetor_Gjykatave_2021.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 26 janar 2023).

<sup>5</sup> Raport statistikor i Gjykatave Vjetor 2022. (Shih linkun: [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/45114\\_RAPORTI%20STATISTIKOR%20I%20GJYKATAVE%20VJETOR%202022.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/45114_RAPORTI%20STATISTIKOR%20I%20GJYKATAVE%20VJETOR%202022.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 30 janar 2023).

Në trajektoren e ngritjes të numrit të lëndëve të pazgjidhura, rolin primar e ka ngritja eksponenciale e numrit të lëndëve të pranuar:



**Tabela 4. Numri i lëndëve të pranuar nga Gjykatat Themelore gjatë viteve 2018-2022.**

Mirëpo, ngritjes së numrit të lëndëve të pazgjidhura përveç ngritjes së numrit të lëndëve të pranuar, i ka dhënë kontribut edhe mos efikasiteti i gjykatësve. Kjo nëse marrim parasysh Rregulloren e KGJK-së mbi normat orientuese, e cila ka qenë në fuqi vitin e kaluar. Kjo pasi numri i gjykatësve për të trajtuar lëndë kontestimore gjatë vitit 2022 ka qenë 107, derisa numri i lëndëve të zgjidhura ka qenë 25,632. Kjo i bie se secili gjykatës në mesatare brenda një viti ka zgjidhur 239.5 lëndë përkundër detyrimit nga KGJK që çdonjëri prej tyre është i obliguar t'i zgjidh 329 lëndë brenda vitit. Sikur të arrihej kjo normë, sistemi gjyqësor do të kishte për rreth 9 mijë e 500 lëndë civile më pak.

Në përputhje me rekomandimin e IKD-së<sup>6</sup>, KGJK me 6 prill 2023 miratoi Rregulloren e re për Normën e Punës së Gjyqtarëve, që paraqet një sistem të ri në lidhje me normat e gjykatësve. Dhënia e efekteve të kësaj rregulloreje mbetet të shihet në fazat pasuese.

#### **4. Sfidimi i drejtësisë civile nga kontratat kolektive**

Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e nënshkruar në vitin 2017 si dhe kontrata tjetër kolektive e nënshkruar në janar të vitit 2021, në nenin 35, paragrafi 7 dhe 8 parasheh të drejtën e kompensimit të të punësuarve në shujta gjatë orarit të punës dhe kompensimin e shpërblimit jubilar të përcaktuar si në kontratë. Dispozita të kësaj natyre përmbajnë edhe kontrata të tjera kolektive.

Mos zbatimi i Kontratave Kolektive është arsyeja kryesore e ngritjes së numrit të lëndëve civile të pranuar nga gjyqësori. Kjo jo me fajin e gjyqësorit, por të Qeverisë që nuk ndau buxhet për implementimin e këtyre kontratave, duke detyruar përfituesit që të drejtat e veta t'i realizojnë në

<sup>6</sup> Nocaj D. “Drejtësia civile në Kosovë, ligji VS praktika”. IKD. Prishtinë. Nëntor 2019. Faqe 21 (Shih linkun <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/11/IKD-Drejt%C3%ABsia-Civile-Ligji-vs.-Praktika-03.11.2019-1.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 29 qershor 2023).

rrugë ligjore, duke e ngarkuar gjyqësorin me lëndë dhe duke e dëmtuar buxhetin me shpenzime procedurale.<sup>7</sup>

Në vitin 2022 janë pranuar 40,826 lëndë të natyrës civile e që mendohet se rreth 40% e lëndëve të pranuara, janë lëndë të kësaj natyre<sup>8</sup>. Kjo i bie se vetëm gjatë vitit 2022, konsiderohet se rreth 16,330 lëndë civile janë lëndë të cilat rrjedhin nga kontestet që ndërlidhen me zbatimin e obligimeve përkitazi me kontratat kolektive.

Nga të dhënat statistikore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK)<sup>9</sup>, në nëntë mujorin e vitit 2022 janë zgjidhur nga ana e Gjykatave Themelore të Republikës së Kosovës dhe degët e tyre gjithsej 4,739 lëndë për paga jubilarë. Në anën tjetër, gjatë këtij nëntëmuajori, gjykatat kanë zgjidhur gjithsej 18,375 lëndë civile. Kështu, rreth 25% të tërësisë së lëndëve të zgjidhura në fushën e drejtësisë civile kanë të bëjnë me paga jubilarë. Pra, çdo e katërta lëndë e zgjidhur civile, i takon pagave jubilarë.

Gjykata Themelore	Raste të zgjidhura për paga jubilarë (nëntë mujori 2022)
Prishtinë	1,401
Pejë	1,232
Gjilan	1,023
Ferizaj	445
Mitrovicë	270
Prizren	208
Gjakovë	150

**Tabela 5. Rastet e zgjidhura në nëntë mujorin 2022 për paga jubilarë nga Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës.**

<sup>7</sup>“Zbatimi i Kontratës Kolektive të Arsimit përmes vendimeve gjyqësore”. Betimi për Drejtësi. Shtator 2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/zbatimi-i-kontrates-kolektive-te-arsimit-permes-vendimeve-gjyqesore/?fbclid=IwAR2spC7HPkpLFLPIGkAG0ECQDtAIUJzOaS058BkyGNhxSZqI3IEwbFOgAJE>).

<sup>8</sup> Instituti i Kosovës për Drejtësi. “Regresi i drejtësisë Civile – Raport i monitorimit të rasteve gjyqësore civile gjatë vitit 2021”. Prishtinë. Shtator 2022. Faqe 7. (Shih linkun: [file:///C:/Users/hp/Downloads/Raporti\\_Drejtesia-civile-2021-1%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/hp/Downloads/Raporti_Drejtesia-civile-2021-1%20(1).pdf)). (Qasur për herë të fundit më 29 qershor 2023).

<sup>9</sup> Përgjigje me shkrim nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. 21 dhjetor 2022.



Kështu, nëse institucionet do të përmbushnin obligimet sipas kontratave kolektive nuk do të vinte deri tek nevoja që punonjësit të ndjekin rrugën ligjore, ashtu që nuk do të vinte deri te krijimi i shpenzimeve procedurale të cilat me raste mund të jenë më të larta se sa vet e drejta që kërkohet. Përtej kësaj, kjo situatë e krijuar e ka zhvendosur drejtësinë civile jashtë binarëve të stabilizimit. Për këto arsye, IKD rekomandon që Qeveria sa më parë t'i ndajë mjetet buxhetore për realizimin e obligimeve që dalin nga kontratat kolektive, në mënyrë që qytetarët mos të jenë të detyruar t'i drejtohen gjyqësorit dhe ky i fundit mos të ngarkohet pa nevojë.

## 5. Ngarkesa me lëndë civile sipas llojit të kontesteve

Gjykatat Themelore dhe degët e tyre gjatë vitit 2022, kanë pasur në punë lloje të ndryshme të kontesteve, duke përfshirë kompensimin e dëmit, kontestet familjare, të punës, shpifje dhe fyerje, konteste që rrjedhin nga kontratat kolektive etj. Sipas të dhënave të KGJK-së, gjykata më e ngarkuar me lëndë del të jetë ajo e Prishtinës me një total prej 32 mijë e 453 lëndë, ndërsa gjykata më e pak e ngarkuar del të jetë, Gjykata Themelore në Mitrovicë, dega në Zubin Potok me gjithsej 39 lëndë në punë.

Në shtatë Gjykatat Themelore dhe degët e tyre, gjatë vitit 2022 prijnë kontestet nga kompensimi i dëmit, me gjithsej 36 mijë e 888 lëndë, pasuar nga kontestet pronësore, kontestet që rrjedhin nga kontratat kolektive etj:



**Tabela 6: Ngarkesa e Gjykatave me lëndë sipas kontesteve.**

Nëse kalkuloohen statistikat e lartcekura, atëherë i bie që diku rreth 32% e lëndëve në punë kanë qenë lëndë nga kompensimi i dëmit. Ndërsa, shqetësuese siç është thënë edhe në raportet e kaluara të IKD-së është numri i madh i rasteve nga pagat jubilarë, ku janë 12.8% e rasteve të gjykatave. Vetëm ajo e Prishtinës gjatë vitit 2022 ka pasur rreth 5,526 raste nga pagat jubilarë.

Më poshtë është paraqitur tabela me secilën gjykatë për lloje të veçanta të kontesteve që i kanë pasur gjykatat gjatë vitit 2022.<sup>10</sup>

Gjykatat dhe degët e tyre	Kompensim dëmi	Konteste Familjare	Konteste të punës	Padi për shpifje dhe fyerje	Konteste pronësore	Konteste që rrjedhin nga kontratat kolektive	Tjera	Totali
Prishtinë	8834	1359	1872	489	4502	5226	10171	32453
Podujevë	828	287	1979	9	535	509	988	5135
Graçanicë	205	51	22	1	335	135	217	966
Lipjan	881	173	107	5	379	1725	541	3811
Glllogoc	1163	171	1260	19	194	82	1096	3985
Gjilan	1177	402	76	12	1138	1152	3187	7144
Kamenicë	164	111	78	4	297	540	750	1944
Viti	693	184	16	8	969	491	3679	6040
Novobërdë	89	13	33	1	178	62	618	994
Prizren	5462	597	79	21	1642	345	1172	9318
Suharekë	1077	145	855	3	871	170	1961	5082
Dragash	96	70	136	1	140	686	170	1299
Mitrovicë	815	403	66	9	1255	674	3033	6255
Leposaviq	2	28	16	0	36	10	35	127
Vushtrri	891	237	52	4	449	1009	722	3364
Zubin Potok	11	5	3	0	8	10	2	39
Skenderaj	782	170	22	8	240	33	735	1990
Gjakovë	1710	359	1518	15	577	327	509	5015
Malishevë	1162	154	967	5	444	63	511	3307
Rahovec	1082	141	756	1	460	15	282	2747
Pejë	1788	417	34	19	256	469	3964	6947
Istog	545	163	79	3	556	137	733	2216
Klinë	784	161	35	1	785	25	774	2565
Deçan	1602	139	4	1	181	177	1047	3151
Ferizaj	4480	375	48	15	1091	424	921	7354
Kaçanik	476	74	108	5	273	280	338	1554
Shtërpçë	89	12	103	4	109	54	69	440
<b>Totali</b>	<b>36888</b>	<b>6401</b>	<b>10324</b>	<b>663</b>	<b>17900</b>	<b>14830</b>	<b>28054</b>	

**Tabela 7: Ngarkesa e gjykatave sipas llojit të kontestit.**

<sup>10</sup> Burimi i të dhënave: Këshilli Gjyqësor i Kosovës – Departamenti i Statistikave.

## 6. Kohëzgjatja e trajtimit të rasteve civile

Në fushën e të drejtës civile kohëzgjatja e procedurave gjyqësore mbetet njëra ndër sfidat kryesore në administrimin e drejtësisë.

*“Afatet e arsyeshme janë paraparë edhe në Ligjin e Procedurës Civile. Sipas Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykatat kanë një muaj afat për mbajtjen e seancës paraprake, dhe një tjetër muaj që të mbajnë shqyrtimet kryesore. Nëse dikush bën kalkulimin e hapave të ndryshme procedurale, lëndët civile duhet të trajtohet brenda dy deri në tre muajve nga data në të cilën është dorëzuar në Gjykatë”,* parashihet në dokumentin “Rritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial” të prodhuar nga procesi i Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit (RFSSL).<sup>11</sup>

Por, sipas llogaritjeve të KGJK-së, të bëra në bazë të një formule të Komisionit Evropian për Efikasitet të Drejtësisë (CEPEJ), mesatarja e kohëzgjatjes së lëndëve të zgjidhura vetëm në shkallë të parë është 1,415 ditë. Kjo i bie se për të marrë epilog një lëndë civile, vetëm në shkallë të parë, qytetarët duhet të presin gjithsej 3.8 vite. Sipas të njëjtës formulë, mesatarja e kohëzgjatjes së trajtimit të lëndëve nga Gjykata e Apelit është 638 ditë apo 1.7 vite. Kështu, në total, kohëzgjatja e një lëndë civile nga momenti i parashtrimit në gjykatë e deri në momentin kur e njëjta përfundon në Gjykatën e Apelit është gjithsej 5.5 vite.

Mesatarja e përgjithshme e kohëzgjatjes së lëndëve gjyqësore qartazi flet për një trajtim të lëndëve gjyqësore civile brenda një afati jo të arsyeshëm kohor. Në këtë drejtim, IKD ka gjetur se kanë ndikuar shumë faktorë, duke nisur nga keqadministrimi i institucioneve administrative dhe performanca e gjykatësve, e edhe administrimi jo adekuat i drejtësisë.

Nisur edhe nga ngritja eksponenciale e numrit të lëndëve të pazgjidhura, kohëzgjatja e procedurave gjyqësore duket se do të vazhdojë të mbetet një prej problemeve kryesore në fushën e drejtësisë civile në Kosovë.

## 7. Mungesa e rasteve gjyqësore për diskriminim

Ligji Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi [neni 13.1.] ka përcaktuar mundësinë që secili person që pretendon të ketë qenë i diskriminuar, të paraqesë padi në gjykatë. Kjo padi [neni 14.3.] mund të parashtrohet brenda afatit prej pesë (5) viteve nga dita që i dëmtuari vie në dijeni për diskriminimin e pësuar. Specifikë e padive të ngritura sipas këtij ligji është se barra e provës nuk bie, si zakonisht, tek paditësi por tek i padituri. Sipas këtij ligji [neni 16.9] procedura gjyqësore në këto raste trajtohet me prioritet.

---

<sup>11</sup> “Rritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial”. Rishikimi Funkcional i Sundimit të Ligjit të Kosovës. Ministria e Drejtësisë. Qershor 2019. Faqe 14.

Gjatë monitorimit, IKD ka gjetur se në përgjithësi, ka mungesë të zbatimit të këtij ligji. Përkundër faktit se në padi të ndryshme ngritët pretendimi për diskriminim, paditë nuk ngritën në bazë të këtij ligji, me kërkesën për të konstatuar ekzistimin e ndonjë prej formave të diskriminimit.

Në raportin “(Pa)Drejtësia dhe Diskriminimi me Bazë Gjinore në marrëdhëniet e punës” IKD gjente se “*nuk ka pasur asnjë rast ku gjykatat kanë vendosur mbi diskriminimin në bazë të Ligjit mbi Diskriminim*”. “*Bazuar në monitorimin e këtyre rasteve, dëshmohet se diçka e tillë veçanërisht ndodhë për shkak se edhe në ato raste vetëm është përmendur në referatin e padisë se në rastet konkrete ekziston diskriminim, kërkesëpadia nuk ka përmbajtur diçka konkrete në këtë drejtim, që nënkupton se pala në padi në asnjë rast nuk ka kërkuar konstatimin e kësaj çështje apo dënimin e institucionit/kompanisë përkitazi me këtë situatë*” thuhej në këtë raport<sup>12</sup>. Numri i vogël i rasteve të ngritura për diskriminim konstatohet edhe në raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit<sup>13</sup>.

Obligimi për aplikimin e këtij ligji, mbi të gjitha, bie mbi avokatët që përfaqësojnë palët në procese të ndryshme gjyqësore. Ligji Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi paraqet një mekanizëm të fuqishëm për konstatimin e diskriminimit në secilin rast dhe për luftimin e diskriminimit në përgjithësi. Për këtë arsye, në drejtim të parandalimit të diskriminimit, aplikimi i këtij ligji mbetet çështje bazike.

## 8. Kontestet e punës me elemente diskriminimi

Siç u tha, në parim, numri i rasteve të iniciuara sipas Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi është i ulët. Përkundër kësaj, IKD ka identifikuar dhe analizuar raste kur në referatat e padive nga marrëdhënia e punës janë ngritur pretendime për diskriminim. Për qëllime të këtij raporti, IKD ka analizuar 20 aktgjykime të kësaj natyre.

Gjetjet e IKD-së dëshmojnë se nga aktgjykimet e analizuar në 15 prej tyre gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve ndërsa në pesë raste të tjera është refuzuar kërkesëpadia. Nga 15 aktgjykimet aprovuese, në katër prej tyre nuk është vendosur për kompensimin e dëmit material ndërkaq në 11 prej tyre është përcaktuar lartësia e kompensimit të dëmit material sipas kërkesës së palës paditëse. Ndërsa, në këto aktgjykime vetëm në një rast është përcaktuar edhe lartësia për kompensimin e dëmit jo-material.

---

<sup>12</sup> Instituti i Kosovës për Drejtësi. “(Pa)Drejtësia dhe Diskriminimi me Bazë Gjinore në Marrëdhëniet e Punës”. Prishtinë. 2021. Faqe 20. (Shih linkun: [file:///C:/Users/hp/Downloads/Final\\_PADREJT%C3%8BSIA-DHE-DISKRIMINIMI-ME-BAZ%C3%8B-GJINORE-N%C3%8B-MARR%C3%8BDH%C3%8BNIET-E-PUN%C3%8BS.pdf](file:///C:/Users/hp/Downloads/Final_PADREJT%C3%8BSIA-DHE-DISKRIMINIMI-ME-BAZ%C3%8B-GJINORE-N%C3%8B-MARR%C3%8BDH%C3%8BNIET-E-PUN%C3%8BS.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 29 qershor 2023).

<sup>13</sup> Raporti vjetor 2022, nr. 22. Institucioni i Avokatit të Popullit. Faqe 52. (Shih linkun: [https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2023/03/OIK\\_AnnualReport\\_alb\\_web\\_01\\_compressed.pdf](https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2023/03/OIK_AnnualReport_alb_web_01_compressed.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 29 qershor 2023).

IKD ka gjetur se në tri raste, gjykata nuk e ka cekur bazën ligjore mbi të cilën është refuzuar kërkesëpadija për pretendimet lidhur me diskriminim.

Ndërkaq, vërehet se gjykata edhe në rastet e aprovimit të kërkesëpadiës në dy raste nuk ka cekur fare bazën ligjore mbi të cilën është pranuar pretendimi për diskriminim, kurse në nëntë raste të tjera, gjykata nuk është lëshuar në bazë konkrete por vetëm është thirrur në nenin 5, paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, i cili përcakton se *“Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligje të tjera në fuqi”*, duke mos specifikuar bazën e diskriminimit.

Kurse, në gjashtë raste gjykata specifikisht ka përmendur bazën juridike të diskriminimit me rastin e vendimmarrjes.

Nga analiza e këtyre aktgjykimeve, rezulton se baza më e shpeshtë sipas të cilave parashtrohet padi për diskriminim është pretendimi për diskriminim në punësim në rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Kështu, nga 20 padi të analizuar për rastet e diskriminimit, 12 prej tyre janë parashtruar duke pretenduar diskriminimin në punësim, gjashtë prej tyre diskriminim në paga, një padi për diskriminim mbi bazën e moshës dhe një padi mbi diskriminimin në kushtet fizike në hapësira publike për persona me aftësi të kufizuara.

Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore përcakton se *“Në kontestet nga marrëdhënia e punës, e sidomos me rastin e caktimit të afateve dhe konvokimit të seancave gjyqësore, gjykata gjithmonë do të ketë parasysh nevojën e zgjidhjes së ngutshme të kontesteve nga marrëdhënia e punës”*.

Sa i përket kohëzgjatjes së trajtimit të këtyre rasteve, tetë padi janë të vitit 2020, tri të vitit 2019, katër të vitit 2018, tri të vitit 2017 dhe nga një rast të viteve 2014 dhe 2013. Nëse bëhet kalkulimi i hapave procedural, lëndët civile duhet të trajtohen brenda dy deri në tre muaj nga data në të cilën padia është dorëzuar në Gjykatë<sup>14</sup>. Ndërsa, në rastin e lëndëve nga marrëdhënia e punës, me pretendime për diskriminim, përkundër kërkesës ligjore për zgjidhje të ngutshme të këtyre lëndëve, mesatarja e kohëzgjatjes nga dita e parashtrimit së padisë e deri tek marrja e një vendimi nga ana e gjykatës rezulton të jetë **3 vite e 1 muaj**.

Nga aktgjykimet e analizuara, në gjashtë raste pala paditëse ka qenë grua me ç’rast në pesë raste i’u është aprovuar kërkesëpadija në rastet e diskriminimit kurse në 14 raste të tjera paditësit kanë qenë burra ku 10 prej tyre janë aprovuese në pretendimet e palës për diskriminim. Në rastet e diskriminimit ku gruaja është pala paditëse, IKD ka gjetur se baza më e shpeshtë është diskriminimi në punësim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

<sup>14</sup> *“Rritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial”*. Rishikimi Funkcional i Sundimit të Ligjit të Kosovës. Ministria e Drejtësisë. Qershor 2019. Faqe 14.

## 9. Mungesa e padive lidhur me sinjalizim

Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve (LMS), i cili ka hyrë në fuqi më 2 janar 2019, ka përcaktuar rregullat, procedurat e sinjalizimit, të drejtat dhe mbrojtjen e sinjalizuesve si dhe detyrimet e institucioneve publike dhe subjekteve private në lidhje me sinjalizimin.

Sinjalizuesi dhe personi i lidhur me sinjalizuesin i cili ka pësuar nga veprimet e dëmshme në lidhje me sinjalizimin, ka të drejtë në mbrojtje gjyqësore, pa qenë i detyruar të sherojë mjetet juridike të brendshme në procedurë administrative. Sipas ligjit [Neni 24.5] *“të gjitha lëndët që kanë të bëjnë me sinjalizimin, trajtohen me prioritet nga Gjykata”*.<sup>15</sup>

Të dhënat zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit flasin për trend në rritje të numrit të rasteve të sinjalizimit. Në vitin 2022, si sinjalizime të jashtme, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka pranuar 13 raste të sinjalizimit, derisa në vitin 2021 kishte pranuar nëntë të tilla.

Por, mbrojtja ligjore e sinjalizuesve duket se ende nuk është trajtuar nga gjykatat. IKD me qëllim të përpilimit të raportit më gjithëpërfshirës i është drejtuar KGJK-së për informata dhe qasje në dokumente publike përkitazi me rastet e padive të ushtruara në Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës që lidhen me të drejtat e sinjalizuesve, mirëpo nga të njëjtit nuk është ofruar qasje në dokumente të tilla.

IKD përmes kërkesave për qasje në informata dhe dokumente publike ka kërkuar nga gjykatat informata nëse kanë pasur në punë lëndë të kësaj natyre. Sipas këtyre përgjigjeve, rezulton se Gjykata Themelore në Pejë me degët e saj në Klinë, Istog dhe Deçan, Gjykata Themelore në Ferizaj me degët e saj në Kaçanik dhe Shtërpçë, Gjykata Themelore në Prizren me degët Suharekë dhe Dragash, Gjykata Themelore në Gjilan dhe ajo në Mitrovicë nuk kanë pranuar apo trajtuar asnjë rast lidhur me çështjen e të drejtave të sinjalizuesve.<sup>16</sup> Gjykatat e tjera nuk kanë kthyer përgjigje.

Mungesa e padive, krahas indikatorëve të tjerë, flet për nivel jo të mjaftueshëm të zbatimit të Ligjit Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Për këtë arsye promovimi i mëtutjemë i këtij ligji mbetet një domosdoshmëri e institucioneve.

## 10. Mbrojtja gjyqësore e pronës

Pronësia paraqet njërin ndër institutet kryesore civile-juridike në çdo rend juridik. Në Kosovë, pronësia garantohet përmes Kushtetutës, Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Ligjit.

<sup>15</sup> Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Neni 24 paragrafi 5.

<sup>16</sup> Përgjigje me shkrim nga Gjykata Themelore e Pejës. 19 janar 2023. Përgjigje me shkrim nga Gjykata Themelore e Prizrenit. 19 janar 2023. Përgjigje me shkrim nga Gjykata Themelore në Ferizaj. 20 janar 2023. Përgjigje me shkrim nga Gjykata Themelore në Gjilan. 01 shkurt 2023. Përgjigje me shkrim nga Gjykata Themelore në Mitrovicë. 08 shkurt 2023.

E drejta e pronësisë më tutje rregullohet në mënyrë më të detajuar me Ligjin Nr.03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.

Për qëllime të draftimit të këtij raporti, IKD ka analizuar gjithsej 20 aktgjykime të Gjykatave Themelore të Republikës së Kosovës dhe 20 aktgjykime të Gjykatës së Apelit lidhur me çështjet pronësore.<sup>17</sup>

Në 20 aktgjykimet e shkallës së parë, në 13 prej tyre është aprovuar kërkesëpadia, në tre raste është refuzuar kërkesëpadia, ndërsa në katër raste të tjera është konsideruar e tërhequr padia.

Sa i përket trajtimit të rasteve pronësore, IKD ka gjetur probleme të theksuara në administrimin e këtyre rasteve. Tutje, në kuptim të kohëzgjatjes së këtyre rasteve, IKD gjen se kohëzgjatja në trajtimin e këtyre rasteve paraqet zvarritje të veçantë përtej zvarritjes së përgjithshme.

Lidhur me trajtimin e këtyre rasteve, bazuar në analizën e 20 aktgjykimeve, del se mesatarja e kohëzgjatjes së trajtimit të lëndëve lidhur me çështjet pronësore në shkallë të parë është **9 vite e 3 muaj**. Ndërkaq, krahasuar me kohëzgjatjen e trajtimit të rasteve që rrjedhin nga kontratat kolektive vërehet një disproporcion i nivelit të lartë të kohëzgjatjes së trajtimit të një lënde të kësaj natyre, kjo pasi që nga momenti i parashtrimit të padisë e deri tek një vendim i Gjykatës Themelore mesatarja e trajtimit të lëndëve që rrjedhin nga kontratat kolektive del të jetë 1 vit e 7 muaj.<sup>18</sup>

Kurse, mesatarja e trajtimit të një rasti të pagave jubilarë nga parashtrimi i padisë deri tek vendimi i Gjykatës së Apelit del të jetë **2 vite e 5 muaj**.<sup>19</sup>

Duke e pasur parasysh kompleksitetin shumë më të theksuar të rasteve pronësore, në raport me kontestet që rrjedhin nga kontratat kolektive, ky dallim kaq i lartë tregon se në vitin 2022 ka pasur anashkalim të kontesteve pronësore dhe fokusim në raste të kontratave kolektive. Në kuptim të sanimit të këtyre situatave, është për tu vlerësuar Rregullorja e re për Normat e Gjyqtarëve, e cila ka adresuar këtë situatë, duke bërë diferencimin e lëndëve gjyqësore, sipas kompleksitetit të tyre.<sup>20</sup>

Në anën tjetër, në analizimin e këtyre aktgjykimeve shihet se katër raste gjykata ka dhënë aktgjykim në bazë të pohimit. Por, përkundër faktit se në këto raste nuk zhvillohet fare procedurë

---

<sup>17</sup> Shënim: Aktgjykimet janë siguruar në web-faqet zyrtare të Gjykatave Themelore të Republikës së Kosovës dhe web-faqen zyrtare të Gjykatës së Apelit.

<sup>18</sup> Shënim: Për analizimin e kohëzgjatjes së trajtimit të rasteve me paga jubilarë janë analizuar 20 aktgjykime të Gjykatave Themelore të Republikës së Kosovës të siguruar në web-faqen zyrtare të Gjykatave.

<sup>19</sup> Shënim: Për analizimin e kohëzgjatjes së trajtimit të rasteve me paga jubilarë në shkallë të dytë janë analizuar 20 aktgjykime të Gjykatës së Apelit të siguruar në web-faqen zyrtare të Gjykatës.

<sup>20</sup> Rregullore Nr.03/2023 për normën e punës së gjyqtarëve. Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Prishtinë. Prill 2023. (Shih linkun: [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/49162\\_Rregullore\\_Nr\\_03\\_2023\\_per\\_normen\\_punes\\_se\\_gjyqtareve.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/49162_Rregullore_Nr_03_2023_per_normen_punes_se_gjyqtareve.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 29 qershor 2023).

(përrjashtimisht konstatimit të disponueshmërisë së kërkesës) aktgjykimet në këto raste janë nxjerrë rreth shtatë vite pas parashtrimit të padive.

Tutje, IKD ka gjetur se dy prej rasteve të analizuara janë raste të kthyer në rigjykim dhe rivendosje nga ana e Gjykatës së Apelit, me ç'rast deri tek marrja e një vendimi nga shkalla e parë që nga paraqitjet e padive në njërin rast kanë kaluar 12 vite, respektivisht nëntë vite në rastin tjetër. Ndërsa, IKD ka gjetur se në një rast në të cilin padia ishte ngritur në vitin 2010 dhe tek në vitin 2022 gjykata kishte refuzuar kërkesëpadinë e paditësit. Kështu, për trajtimin e këtij rasti kishin kaluar gjithsej 12 vite deri në marrjen e aktgjykimit nga shkalla e parë.

Dukuria e kthimit të shpeshtë të rasteve në rigjykim dhe rivendosje është shumë e theksuar në rastet e kontesteve pronësore. Për qëllime të këtij hulumtimi, IKD ka analizuar edhe 20 vendime të Gjykatës së Apelit në kontestet pronësore. Me këtë rast, IKD gjen se Gjykata e Apelit në gjashtë raste ka vërtetuar vendimet e gjykatave të shkallës së parë kurse në 14 raste ka prishur vendimet e Gjykatave Themelore të Republikës së Kosovës dhe ka kthyer lëndët civile në rigjykim dhe rivendosje.

Në rastet e kthyer në rigjykim sipas Gjykatës së Apelit shihet se arsyetimi i vendimeve fillon me një shabllon se *“vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike nuk është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe rrjedhimisht edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar”*.

Kurse, arsyeja më e madhe e kthimit të rasteve në rigjykim, përkatësisht në 10 raste të tilla është sipas Gjykatës së Apelit se vendimet e shkallës së parë janë përfshirë në shkeljen thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2, pika n) *“në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit;”*.

Ndërsa në dy raste të tjera thuhet se vendimet gjyqësore kanë tejkaluar kërkesëpadinë derisa në dy raste të tjera thuhet se vendimet e shkallës së parë janë përfshirë në shkelje të tjera procedurale [Ligji i Procedurës Kontestimore, neni 182.2, pika k].

Kthimi i rasteve në rigjykim, është një prej arsyeve kryesore për shkaktimin e zvarritjeve procedurale, si në raste të tjera, ashtu edhe në rastet pronësore. Nga analizimi i këtyre vendimeve del se nga momenti i marrjes së vendimit nga ana e shkallës së parë e deri tek marrja e një vendimi nga Gjykata e Apelit mesatarisht kalon **3 vite e 5 muaj** derisa nga momenti i paraqitjes



së padisë e deri tek një vendim i Gjykatës së Apelit mesatarisht koha e trajtimit të rastit për lëndët pronësore është **7 vite e 8 muaj**, duke mos llogaritur procedurën sipas rigjykimit, në rastet kur vendimet e gjykatave themelore prishen nga ana e Gjykatës së Apelit.

Në këtë mënyrë, në bazë të kësaj analize, IKD gjen se sistemi i drejtësisë gjatë vitit 2022 nuk ka arritur që në mënyrë adekuate të trajtojë rastet pronësore. Kjo mënyrë e veprimit të sistemit të drejtësisë e zbeh jetësimin në praktikë të një të drejte bazike të qytetarëve, asaj në pronë.

## 11. Ndërmjetësimi në kontestet juridiko-civile

Ndërmjetësimi është njëra prej mënyrave më efikase për zgjidhjen jashtëgjyqësore të kontesteve, e cila procedurë u mundëson palëve që të zgjidhin lëndët e tyre pa formalitete procedurale e po ashtu edhe i liron gjykatat nga një numër i konsiderueshëm i lëndëve.

Strategjia për Sundim të Ligjit thekson se *“Pavarësisht rregullativës ligjore, kryesisht të mirëfilltë për arbitrazhin dhe sidomos për ndërmjetësimin, palët rrallë herë i përdorin ato. Palët janë pak të informuara për mundësitë që ato i krijojnë për zgjedhje efikase të kontesteve”<sup>21</sup> dhe se “Stimulimi i përdorimit të mekanizmave alternative për zgjidhje të mosmarrëveshjeve (ZAK), siç janë arbitrazhi (për çështjet civile) dhe ndërmjetësimi (çështje civile dhe penale) do të ndikojë dukshëm në uljen e numrit të lëndëve të nevojshme që zgjidhen nga gjykatat”<sup>22</sup>.*

Procedura e ndërmjetësimit rregullohet me Ligjin Nr.06/L-009 për Ndërmjetësimin, i cili parasheh mënyrën, funksionimin, procedurën dhe organizimin e ndërmjetësimit, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e ndërmjetësuesve me qëllim të lehtësimit të qasjes në zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve dhe kontesteve si dhe të promovon zgjidhjen miqësore të tyre. Ky ligj kategorizon edhe natyrat e rasteve gjyqësore të përshtatshme për ndërmjetësim dhe ka përcaktuar edhe ndërmjetësimin e detyrueshëm<sup>23</sup>.

Sa i përket ndërmjetësimit si mënyrë alternative e zgjidhjes së kontesteve, IKD gjen se viti 2022 ka një trend të theksuar pozitiv. Sipas të dhënave statistikore të Ministrisë së Drejtësisë<sup>24</sup>, vërehet se nga Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës lidhur me rastet civile, në vitin 2020 në procedurë të ndërmjetësimit ishin referuar vetëm 143 raste, derisa ky numër ishte ngritur në vitin 2021, ku në procedurë të ndërmjetësimit ishin referuar gjithsej 887 raste. Ngritje e theksuar e referimit të rasteve në procedurë të ndërmjetësimit vërehet se është shënuar gjatë vitit 2022, ku gjykatat në këtë procedurë kanë referuar gjithsej 4,269 raste.

<sup>21</sup> Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021 – 2026. Ministria e Drejtësisë. Korrik 2021. Faqe 13. (Shih linkun: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6DC1CBD5-0DF1-46AE-9D1A-78C96146C7D0.pdf>). (Qasur për herë të fundit 29 qershor 2023).

<sup>22</sup> Po aty. Faqe 27.

<sup>23</sup> Ligji Nr.06/L-009 për Ndërmjetësimin. Neni 9.

<sup>24</sup> Përgjigje me shkrim nga Ministria e Drejtësisë. 26 janar 2023.

Kështu, IKD gjen se gjatë vitit 2022 ka pasur një trend pozitiv në ngritjen e numrit të rasteve të referuara në ndërmjetësim. Siç dihet, përmban në vetvete dobi të shumëfishta, si për palët ashtu edhe për sistemin e drejtësisë. Trendi i rritjes së numrit të lëndëve të referuara në ndërmjetësim duhet të vazhdojë të rritet derisa procedura e zgjidhjes së kontesteve përmes ndërmjetësimit të jetë procedurë mirë e njohur tek qytetarët.

Në tabelën në vijim janë paraqitur statistikat që kanë të bëjnë me zgjidhjen e rasteve të referuara në ndërmjetësim:

	Raste të zgjidhura	Raste të pazgjidhura	Në procedurë	Refuzuar ndërmjetësimin
2020	53	90		
2021	642	222	23	
2022	1,201	472	2,366	230

**Tabela 8. Trajtimi i rasteve civile në procedurë të ndërmjetësimit për vitet 2020-2022.**

## 12. Ngarkesa në mënyrë jo proporcionale e gjyqtarëve me lëndë civile

Shpërndarja proporcionale e gjykatësve, në përputhje me ngarkesën me lëndë, paraqet administrim të mirë të sistemit të drejtësisë, që ndikon edhe në ngritjen e efikasitetit.

Sa i përket shpërndarjes së tillë, IKD gjen se në vitin 2022, duke krahasuar ngarkesën me lëndë në katër gjykata dhe numrin e gjykatësve që merren me trajtimin e lëndëve civile rezulton se në mesatare, një gjykatës në Gjykatën Themelore në Prizren është i ngarkuar me 1634 lëndë, në Ferizaj me 1,350 lëndë, derisa një gjykatës në Gjykatën Themelore në Gjiilan është i ngarkuar me 902 lëndë dhe në Mitrovicë me 908 lëndë. Në këtë mënyrë, del se kemi shpërndarje jo-proportionale të gjykatësve në mes të Gjykatave Themelore të Prizrenit, Ferizajit në njërin anë dhe asaj në Gjiilan dhe Mitrovicë në anën tjetër.

Gjykata Themelore	Numri i lëndëve civile në punë	Numri i gjyqtarëve në trajtimin e lëndëve civile	Mesatarja e ngarkesës me lëndë për një gjyqtar
Prizren	9,809	6	1,634
Ferizaj	8,105	6	1,350
Mitrovicë	6,359	7	908
Gjilan	6,317	7	902

**Tabela 9. Mesatarja e ngarkesës me lëndë për një gjyqtar në Gjykatat Themelore në vitin 2022.**

Duke pasur parasysh këto të dhëna, KGJK duhet të kujdeset që gjykatësit të shpërndahen proporcionalisht me ngarkesën e lëndëve që ka një gjykatë ashtu që kjo të ndikojë në uljen e numrit të lëndëve të pazgjidhura dhe ngritjes së efikasitetit. Në këtë situatë, KGJK duhet të synojë që këtë ta arrijë edhe përmes institutit të transferimit të gjykatësve.